



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Asistente Ekzekutive

Numri i referencës : ASK-ZKE-001

Koeficienti :7

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Siguron mbështetje administrative dhe teknike përfshirë: postën zyrtare, telefonatat, skanimet, faksimet, kopjimet e dokumenteve si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme.
- Komunikon direkt dhe në emër te mbikëqyrësit në njësit organizative të brendshme ,
- Përgatit dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet , memorandumet dhe e-malet për mbikëqyrësin,
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikëqyrësin,
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik, kopjet fizike të dokumenteve të dosjes së zyrës së mbikëqyrësit ,
- Menaxhon kalendarin e takimeve ,
- Ndihmon mbikëqyrësin në caktimin dhe koordinimin e takimeve të ndryshme dhe merr pjesë në takime nëse është e nevojshme,
- Për punët dhe detyrat e kryera i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kualifikimi arsimor: Shkollimi bachelor nga fushat ekonomike, sociale, bujqësisë apo të ngjashme

-Përvoja : Së paku 4 vite përvojë pune në fushën relevante .

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri në të gjitha aspektet e ofrimit të shërbimeve dhe koordinimit si dhe aftësi në punët administrative –teknike.
- Aftësi pune me kompjuter (Word ,Excel ,Power Point ,Access)
- Njohja e gjuhës angleze,
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të caktuara,
- Shkathtësi të mira të komunikimit,
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të personelit në nivelin administrativ dhe teknik

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë perioda e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës , vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.